



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 447, datë 29.6.2022

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.150, DATË 10.3.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT
PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS ADMINISTRATIVE,
NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN
VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAMZË
SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr.150, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1 Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Kamzë për financimin e ndërtimit të godinës administrative, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, në masën 162 427 441 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar."

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3720/3
DATË 30.6. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KAMZË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

